



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1253_11_14**;
- Ankesa e konsumatorit e datës **24.12.2014**.

në seancën e mbajtur më datë 20 shkurt 2015, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit S. K. me shifër DFE - 9011768 ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II **Shfuqizohet** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_1253_11_14 i datës 18.11.2014, për shkak se vlera e korigjimit të përcaktuar në vendim prej **-73.35€** duhet të ndryshohet dhe të korigjohet në vlerë prej **-53.35€**.

A r s y e t i m

Me datë 03.02.2013 Departamenti për Konsumator në KEK i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën janar 2013 në vlerë financiare **279.82 €**. Me datë 11.02.2013 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për konsumator në KEK duke kundërshtuar faturën e muajit janar 2013 për shkak të leximit dhe faturimit jo të saktë.

Me datë 16.02.2013 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, dhe kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr. 17667911, ku TL=55033 kWh (tarifa e lartë) dhe TU= 00002 kWh (tarifa e ulët). Pas kësaj Departamenti për Konsumator në KEK me datë 16.02.2013 i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij bazuar në listat e leximit, si dhe rrjedhës së energjisë elektrike. Konsumatori përgjigjen e ka pranuar me datë 27.01.2014.

Konsumatori pas marrjes së përgjigjes së KEK-ut me datë 03.03.2014 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE. DMK pas kësaj ka shqyrtuar ankesën e konsumatorit dhe me datë 18.11.2014 ka nxjerrë vendim duke e **aprovuar** ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEDS-i që të korigjoj faturën 01130DFE-9011768 e datës 03.02.2013 në vlerë **-73.35€** duke bërë shpërndarjen e shpenzimit të energjisë elektrike nga periudha 05/2010 deri më 01/2013.

Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se është i pakënaqur me vendimin e DMK të ZRRE-së, dhe në ankesë ka parashtruar tri pika për aprovim. Në pikën 1 konsumatori ka kërkuar që kilovatët e



grumbulluar të llogariten vetëm me çmimin e verës për vitin 2010. Në pikën 2 kërkon që ti bëhet kompensimi në vlerë prej 500€ për shkak të ndërprerjes së rrymës për dy ditë. Në pikën 3 kërkon kompensim në vlerë prej 1000€ për sjellje jo njerëzore nga ana e zyrtarëve të KEDS-it.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 20 shkurt 2015 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit, përkatësisht bazën e kundërshtimit të tij në ankesë dhe pas vlerësimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës ka vlerësuar se argumentet e prezantuara nga ana e konsumatorit nuk janë bindëse për faktin se me asnjë provë nuk ka argumentuar se DMK ka dëmtuar konsumatorin financiarisht gjatë vendosjes së kësaj çështje, por që përkundër kësaj sipas vendimit të DMK-së konsumatorit i janë korrigjuar edhe për 20€ më tepër se që është dashtë për shkak të një gabimi teknik të shkaktuar gjatë llogaritjes së faturave kontestuese.

Sa i përket pikës së parë të kundërshtimit nga ana e konsumatorit për kalkulimin e kilovatëve të grumbulluar të llogariten vetëm me çmimin e verës për vitin 2010, Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se KEDS nga periudha 05/2010 deri në periudhën 07/2011, si dhe për periudhën 11/2011 deri në periudhën 01/2013 nuk ka bërë lexim dhe faturim të saktë të shpenzimeve mujore të energjisë elektrike dhe me këtë rast nuk ka respektuar saktë nenin 5, paragrafi 3, nën paragrafi 3.6, nenin 21 të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji në të cilën ndërmarrja e energjisë (OSSH) obligohet të sigurojë lexim dhe faturim të saktë, si dhe nuk ka respektuar saktë procedurën e leximit dhe faturimit të konsumatorëve tarifor. Lidhur me këtë Bordi i ZRRE-së, ka konstatuar se përveç gabimit teknik që është bërë në kalkulim në vlerë prej 20€ siç është theksuar edhe më lartë llogaritja e faturave të konsumatorit të paraqitura në vendimin e DMK-së është bërë konform rregullave dhe procedurave në fuqi dhe vendimit për përcaktimin e tarifave si dhe është marr për bazë periudha kontestuese e kalkulimit të tarifave sipas sezoneve që kanë qenë kontestuese.

Lidhur me pikën e dytë të kundërshtimit për kompensimin në vlerë prej 500€ për shkak ndërprerjes së rrymës për dy ditë, Bordi i ZRRE-së ka vendosur se kjo kërkesë është krejtësisht e pabazë pasi që konsumatori me asnjë provë nuk ka dëshmuar atë që thekson në këtë pikë kontestuese, gjithashtu në rast se konsideron se si rezultat i kësaj është dëmtuar nga KEDS, i njëjti mund t'i drejtohet gjykatës kompetente për kompensim dëmi.

Sa i përket pikës së tretë në ankesë për kompensim në vlerë prej 1000€ për shkak të sjelljeve jo njerëzore nga ana e punëtorëve të KEDS, Bordi i ZRRE-së edhe për këtë pikë kontestuese konstaton se edhe për kundër faktit se edhe kjo pikë është e paargumentuar me ndonjë provë konkrete njëkohësisht vërehet se konsumatori vetëm i referohet një shume të hollash për kompensim dëmi paushallë, dhe përveç kësaj Bordi nuk merret me rastet e sjelljeve të punëtorëve të KEDS, pasi që përgjegjëse për këtë është Kompania KEDS që menaxhon me punëtorët e saj dhe në rast të sjelljeve të pahijshme të ndonjë zyrtari siç theksohet në ankesë konsumatori ka qenë dashtë të informoi Menaxhmentin e KEDS apo organet e ndjekjes në këtë rast policinë dhe pas kësaj ka mund të procedojë edhe më tutje që ta zgjedhë këtë rast edhe në gjykatë. Po ashtu duhet theksuar se konsumatori në ankesën e parashtruar DMK-së si shkallë e parë asnjërin prej pikave të theksuara në ankesë për bordin nuk i ka paraqit ankesës së DMK-së, përveç që ka kërkuar shpërndarjen e kilovatëve prej muajit maj deri në muajin janar, andaj është i palogjikshëm fakti se konsumatori e apelon vendimin e shkallës së parë pa e sulmuar asnjërin nga pikat e vendimit por që vetëm kërkon kompensim dëmi për sjellje të pa hijshme nga punëtorët e KEDS.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar me kujdes edhe korrigjimin e bërë nga DMK në ZRRE dhe ka vërejtur se DMK me rastin e korrigjimit të faturave të konsumatorit në vlerë prej -73.35€ duke bërë shpërndarjen e shpenzimit të energjisë elektrike për periudhën 05/2012 deri më 01/2013 ka bërë një gabim teknik gjatë kalkulimit pasi që në vend të vlerës së korrigjuar prej -53.35€ ka vendosur që konsumatori të korrigjohet me vlerë prej -73.35€ dhe mbi bazën e kësaj Bordi ka vendosur që të prish



edhe vendimin e DMK-së duke vendosur që korrigjimi i faturave të konsumatorit të bëhet në vlerë prej -53.35€.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 20.02.2015 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK_V_1253_11_14, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmive tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar